

KONTRATË SHITJE

Sot më datë 22/11/2023 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme:

PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

- **Enid Bala**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I61229043M , lindur më Tirane, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)
- **Klevis Miho**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I60612072T , lindur më Tirane, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)
- **Enkelejd Musabelliu**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I70205085E , lindur më Skrapar, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Shitësi)
- **Taufant Musabelliu**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I01021087U , lindur më Skrapar, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri (Blerësi)
- **Erind Aliçkolli** shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I70402100U , lindur më Pogradec, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blerësi)

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Enid Bala, Klevis Miho dhe Enkelejd Musabelliu te cilet përfaqësojnë 20% të kapitalit të shoqërisë "Tok Digital Agency me numër unik (NUIS) L62126009T, me adresë Tirane Tirane Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Kati 6, Hyrja 14, 1019 Tirane.

- Shitjen e kuotës zotëruese nga ortakët Enid Bala, Klevis Miho dhe Enkelejd Musabelliu **12.5 % per secilin** të kuotave te tyre ne total **37.5%** e kuotave: tek Taulant Muasbelliu **18.75%** te kuotave ,Erind Aliçkolli **18.75%** te kuotave.

Neni 2

Cmimi

Cmimi i shitjes së 3 (një) kuote e cila përfaqëson 37.5 % të kapitali të shoqërisë "Tok Digital Agency" është 2 625 000 lek .

Neni 3

Afati i pagimit te cmimit

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitesit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates;

Neni 5

Te drejtat dhe detyrat e bleresit

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesit nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qëndrën e ushtrimit të aktivitetit



Neni 6
Zgjidhja e kontratës

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhë kontratën kur:

- a) blerësi nuk paguan cmimin,
- b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
- c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2. Blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

- a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
- b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtesë 10 ditor, të caktuar nga blerësi ;
- b) shitësi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do të dorëzojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

Neni 7
Pasojat e zgjidhjes se kontrates

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjyqates se "Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Neni 9
Shpenzimet per lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

Neni 10

Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakëve Enid Bala, Klevis Miho dhe Enkelejd Musabelliu të shoqërisë "Tok Digital Agency" Shpk në datën 22.11.2023 kalojnë në pronësi të, **Taulant Musabelliu, dhe Erind Aliçkollli** si më poshtë:

- Kuota zotëruese nga Enid Klevis Dhe Enkelejd Musabelliu të cilet përfaqësojnë 12.5% të kapitalit të shoqërisë secili ose 37.5 % në total i kalojnë Taulant Musabelliu 17.75% me vlerë 1 242 000 dhe 17.75% i kalojnë Erind Aliçkollli 1 242 000 leke dhe 7.5% për secilin ngelen te ortakët ekzistues Enid Bala, Klevis Miho dhe Enkelejd Musabelliu. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 22.11.2023

Neni 11


Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në 2 (dy) kopje nga një për secilën palë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSIT :

Enkelejd Musabelliu



Enid Bala

ENID BALA 

Klevis Miho

KLEVIS MIHO



BLERESI :

Taulant Musabelliu

Erind Aliçkollli

